



Nr. 341 Prot.

Tiranë më 04.05.2020

Drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Znj. Ogerta Manasterliu

Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Znj. Besa Shahini

Per dijeni: Z. Edi Rama  
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Lënda: Propozim i protokollit sanitar për organizimin e ndeshjeve të futbollit.

Të nderuara zonja Ministre,

Me shkresën Nr. 373 Prot, datë 22.04.2020, Federata Shqiptare e Futbollit ju ka propozuar që aktivitetet futbollistike për pjesën e mbetur të sezonit të luhen pa praninë e spektatorëve dhe në masa të rrepta higjieni, duke sugjeruar që faza stërvitore, të ri-fillonte në datën 2 Maj 2020, për veprime stërvitore standarde pa kontakt fizik, ndërsa kampionatet kombëtare të futbollit të rifillojnë rreth datës 20 Maj 2020.

Në vijim të kësaj shkrese të mbetur pa përgjigje zyrtare nga ana Juaj, duke marrë shkas nga eksperiencia e pjesës më të madhe të vendeve Europiane, Ju dërgojmë një propozim mbi protokollin sanitar të organizimit të ndeshjeve të futbollit.

Përmes kësaj shkrese, Ju kërkojmë të krijojmë një grup pune të përbashkët për implementimin e këtij protokollit.

Ky protokoll është përgatitur pas konsultimeve me ekspertet e FIFA-s, UEFA-s dhe disa federatave homologe, si dhe me stafin mjekësor të ekipeve kombëtare.

Duke shprehur edhe një herë, gatishmërinë për të bashkëpunuar e për të zbatuar me rigorozitet udhëzimet e ekspertëve, mbetemi besimplotë në reagimin tuaj pozitiv.

Me konsideratë,

Ilir SHULKU  
Sekretar i Përgjithshëm



SPONSOR I PARTIS



SPONSOR I PARTIS



SPONSOR I PARTIS

